



KODI I SHPËRNDARJES

N.Q"Termokos"sh.a , Prishtinë

Qershor 2013

Parathënie	3
I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	5
I.1 Qëllimi dhe shtrirja	5
I.2 Përgjegjësia për Zbatim	6
I.3 Përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të energjisë termike	6
I.4 Përdorimi i shënimeve dhe informatave (konfidencialiteti)	7
I.5 Rrethanat e Paparashikuara	7
I.6 Situatat e Jashtëzakonshme(Emergjente)	8
I.7 Hierarkia	8
I.8 Ndryshimet dhe Plotësimet e Kodit të Shpërndarjes	8
I.9 Komunikimet në mes OSSH dhe Shfrytëzuesve (Përdoruesve).....	8
I.10 Derrogimet	8
I.11 Kontestet (Mosmarrëveshjet)	10
I.12 Administratori i Kodit	10
II. NOCIONET DHE PËRKUFIZIMET	10
III. KUSHTET TEKNIKE DHE KUSHTET TJERA PËR FUNKSIONIM TË SIGURT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES.....	12
III.1 Karakteristikat e Sistemit të shpërndarjes së energjisë termike.....	12
III.2 Planifikimi dhe zhvillimi i Sistemit të shpërndarjes	13
III.3 Mirëmbajtja, riparimet dhe testimi i Sistemit të shpërndarjes.....	14
III.4 Mbikëqyrja dhe sigurimi i Sistemit të shpërndarjes.....	15
III.5 Shërbimi i gatishmërisë së përhershme	16
III.6 Kryerja e aktiviteteve në Sistemin e shpërndarjes	17
III.7 Punimet e planifikuara në Rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike	17
III.8 Punimet e pa-planifikuara – të jashtëzakonshme	18
III.9 Shkyçja nga rrjeti i shpërndarjes – Ndërprerja e furnizimit me energji termike.....	19
IV FUNKSIONIMI (OPERIMI) I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES.....	20
IV.1 Shërbimet e sistemit.....	20
IV.2 Administrimi, menaxhimi dhe ofrimi i qasjes në Sistemit të shpërndarjes.....	20
IV.3 Rezervimi i kapaciteteve të rrjetit të shpërndarjes	21
V. KUSHTET TEKNIKE DHE KUSHTET E TJERA PËR KYÇJE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES.....	22
V.1 Të përgjithshme.....	22
V.2. Objektivi.....	22
V.3 Qëllimi	23
V. 5 Informatat dhe të dhënat e kërkuara për Kyçje	24

Parathënie

Në këtë seksion është dhënë një pasqyrë e shkurtër e sistemit termoenergjetik të NQ Termokos, aktiviteve kryesore në kuadër të përdorimit të sistemit të shpërndarjes dhe baza ligjore dhe obligimet që rrjedhin nga ky Kod.

1 Struktura e Sistemit Termoenergjetik të NQ Termokos

1.1 Sistemi Termoenergjetik i NQ Termokos përbëhet nga: Njësitë Prodhuese të energjisë termike, Sistemi i Shpërndarjes së Energjisë Termike dhe Furnizimi Publik.

1.2 Kapaciteti termik prodhues i instaluar në Ngrohtoren Qendrore të N.Q“Termokos“sh.a është 116 MW_t. Përveç kësaj kjo kompani posedon edhe Ngrohtoren në Qendrën Spitalore me kapacitet termik prej 15 MW_t, si dhe kapacitetin gjenerues termik prej 4 MW_t për nevojat e ngrohjes së lëndës djegëse dhe nevoja tjera interne. Pra gjithsej ka kapacitet të instaluar të energjisë termike prej 135 MW.

1.3 Sistemi i Shpërndarjes i NQ Termokos mundëson furnizimin me energji termike për pjesën urbane të qytetit të Prishtinës në katër lagjet e Prishtinës: Dardani, Qendër, Ulpianë dhe Kodra e Diellit. Sistemi i Shpërndarjes së energjisë termike është pjesë integrale e ndërlidhur me sistemin qendror të prodhimit të energjisë termike. Ky sistem ka dy pika kyçese (lidhëse) me burimin / prodhimin e energjisë termike: Dalja 1 me tubacion me diametër DN 600 mm i cili furnizon me ngrohje lagjet Dardani dhe Qendër, kurse Dalja 2 me tubacion me diametër DN 500 mm i cili furnizon me ngrohje Lagjet Ulpiana, Kodra e Diellit dhe Qendrën Klinike Universitare të Kosovës .

2 Aktivitetet Kryesore të Subjekteve të Sistemit Termoenergjetik të NQ Termokos

2.1 Prodhuesi i Energjisë Termike

2.1.1 Aktivitetet kryesore të Prodhuesit të energjisë termike janë si më poshtë:

- a) Prodhim cilësor dhe sasior i energjisë termike për të përmbushur kërkesat e Furnizuesit publik gjegjësisht konsumatorëve për energji termike për ngrohje qendrore; niveli sasior dhe i cilësisë është i kushtëzuar me gjendjen teknike të sistemit dhe gjithashtu varet nga kushtet atmosferike.
- b) Përgjegjësia për zbatimin e udhëzimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për kontrollin dhe rregullimin e parametrave bazë të furnizimit me energji termike: Temperaturave, presionit dhe prurjes.

- c) Ofrimi i informacioneve të sakta dhe në kohë për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për ngjarje të planifikuara dhe të paplanifikuara.

2.2 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

2.2.1 Aktivitetet kryesore të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes janë:

- a) Operimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të shpërndarjes;
- b) Transportimi në mënyrë të sigurt dhe efikase i energjisë termike nga prodhuesi gjer tek Furnizuesi gjegjësisht Konsumatorët;
- c) Planifikimi i ndërprerjeve për Sistemin e Shpërndarjes dhe për Shfrytëzuesit (përdoruesit) e kyçur në Sistemin e Shpërndarjes;
- d) Ndërmarrja e masave për menaxhimin e sigurisë;
- e) Planifikimi afatgjatë dhe afatshkurtër i Sistemit të shpërndarjes, si dhe menaxhimi i projekteve për zgjerim të sistemit;
- f) Menaxhimi i kyçjeve (lidhjeve) të reja dhe kontrollimi dhe inspektimi i kyçjeve (lidhjeve) ekzistuese.

2.3 Furnizuesi Publik

2.3.1 Furnizuesi publik kryen aktivitetet kryesore si më poshtë:

- a) Furnizimi i konsumatorëve fundor në sasi dhe cilësi të përcaktuar;
- b) Faturimi dhe arkëtimi i pagesave nga konsumatorët për energjinë termike të konsumuar;
- c) Dhënia e informacionit mbi kërkesat e konsumatorëve për energji termike tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

3 Përdorimi i Sistemit të Shpërndarjes

3.1 Përdorimi i Sistemit të shpërndarjes përfshinë aktivitetet kryesore si në vijim:

- a) Kyçja (lidhja) në hyrje ose dalje të Sistemit të shpërndarjes. Pika hyrëse është kyçja (lidhja) në mes të Burimit / Njesisë prodhuese të energjisë termike dhe Sistemit të shpërndarjes. Pika dalje është kyçja (lidhja) në mes të Sistemit të shpërndarjes dhe nënstacionit të konsumatorit.
- b) Transportimi/shpërndarja e energjisë termike nga pikat hyrëse gjer te pika dalje;

- c) Ndërtimi i pikave kyçëse (lidhëse);
- d) Puna dhe operimi me stabilimentet dhe pajisjet përkatëse të ndërlidhura me Sistemin e shpërndarjes;

4 Baza Ligjore dhe Obligimet që Rrjedhin nga Kodi i Shpërndarjes

- 4.1 Kodi i Shpërndarjes është përgatitur nga Operatori i Sistemit të shpërndarjes bazuar në kërkesat që dalin nga legjislacioni ekzistues – Ligji për Ngrohje Qendrore nr03/L-116, neni 31 dhe Licenca e Shpërndarjes së Ngrohjes ZRRE-Li-11/12.
- 4.2 Ky dokument është përpiluar sipas kërkesave të nenit 4, paragrafi 1 të Licencës për Operatorin e shpërndarjes së energjisë termike, ku ndër tjera specifikohet se, i Licencuari duhet të hartoj Kodin e Shpërndarjes dhe ta dorëzoj në ZRRE për aprovim.
- 4.3 Në këtë Kod definohen aspektet teknike dhe marrëdhëniet në mes të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe shfrytëzuesve (përdoruesve) të sistemit. Ky kod është obligativ për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, Prodhuesit e energjisë termike që janë të kyçur në rrjetin e Shpërndarjes të cilët duhet të lidhin marrëdhënie kontraktuese me Operatorin e Sistemit shpërndarjes për përdorimin e sistemit, si dhe për të gjithë shfrytëzuesit (përdoruesit) tjerë të Sistemit të Shpërndarjes.

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

I.1 Qëllimi dhe shtrirja

- I.1.1 Ky Kod rregullon funksionimin dhe mënyrën e menaxhimit të Sistemit të shpërndarjes së energjisë termike për ngrohje qendrore (më tutje: Sistemi i shpërndarjes) i cili operohet nga NQ Termokos sh.a. (më tutje në tekst: Operatori i Sistemit të Shpërndarjes - OSSH).
- I.1.2 Ky Kod përmban procedura që mundësojnë operim të sigurt të Sistemit të shpërndarjes duke marrë parasysh një spektër të gjerë të kushteve teknike dhe operacionale që ndeshen si në situatat normale ashtu edhe në ato të jashtëzakonshme.
- I.1.3 Kodi i shpërndarjes nuk mund të parashikojë dhe adresoj të gjitha situatat e mundshme operacionale, prandaj shfrytëzuesit e sistemit duhet të mirëkuptojnë faktin që OSSH, në situatat e tilla të paparashikuara, do duhet të ushtroj me maturi përgjegjësitë e veta, në pajtim me dispozitat (kushtet) e përgjithshme të këtij kodi.
- I.1.4 Me këtë Kod të shpërndarjes duhet të jenë në pajtim Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Gjeneratori(ët) ekzistues dhe potencial, furnizuesi(t) dhe konsumatorët e

kyçur apo ata që kërkojnë të kyçen në Sistemin e shpërndarjes, të cilëve zakonisht iu referohemi si Shfrytëzues (përdorues) siç edhe janë të definuar në pjesët e ndryshme të këtij kodi.

I.1.6 Ky Kod gjithashtu duhet zbatuar nga subjektet ligjore dhe fizike të cilët projektojnë, ndërtojnë dhe punojnë në mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes dhe pajisjeve dhe objekteve që janë pjesë përbërëse e këtij rrjeti .

I.1.7 Para së gjithash ky Kod përshkruan:

- a) Kushtet teknike, të sigurisë dhe kushtet tjera për funksionim të sigurt të Sistemit të shpërndarjes për të mundësuar furnizim të qëndrueshëm dhe kualitativ me energji termike;
- b) Procedurat për funksionimin e Sistemit të shpërndarjes në raste të jashtëzakonshme;
- c) Kushtet teknike dhe të tjera për kyçjen në rrjetin e shpërndarjes;
- d) Kushtet e përgjithshme teknike për furnizim me energji termike nga rrjeti i shpërndarjes

I.1.8 Kodi i Shpërndarjes përdoret për rrjetin e shpërndarjes së Kompanisë së Ngrohjes Qendrore të zonës së caktuar gjeografike në komunën e Prishtinës.

I.2 Përgjegjësia për Zbatim

I.2.1 Licenca e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes obligon Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për të zbatuar këtë Kod; për të bërë këtë OSSH do të duhet të ketë qasje në pronën dhe objektet si dhe shërbimet e Shfrytëzuesve (përdoruesve), ose të lëshoj udhëzime për Shfrytëzuesit (Përdoruesit), p.sh. për të ndërprerë operimin ose shkyçur një impiant, pajisje etj.

I.2.2 Shfrytëzuesit (Përdoruesit) e sistemit duhet ti sigurojnë OSSH të drejtën për qasje në pronë, objekte dhe shërbime si dhe ti zbatojnë udhëzimet të cilat mund të kërkojnë me qëllim të zbatimit të Kodit të Shpërndarjes

I.3 Përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të energjisë termike

I.3.1 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së energjisë termike është përgjegjës për:

- a) Shpërndarjen e energjisë termike;
- b) Funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes;
- c) Sigurimin e kapaciteteve afatgjate të rrjetit shpërndarës për të mundësuar realizimin e kërkesave racionale për kyçe dhe qasje në rrjet;

- d) Sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme për të plotësuar kërkesat për energji termike;
- e) Trajtimin jo-diskriminues ndaj shfrytëzuesve të Sistemit të shpërndarjes;
- f) Sigurimi i të gjitha të dhënave dhe informatave të nevojshme për konsumatorët dhe shfrytëzuesit e sistemit për qasje efikase në rrjetin e shpërndarjes;
- g) Parashikimin e kërkesave për energji termike duke përdorur metodën e planifikimit gjithëpërfshirës dhe duke marrë parasysh masat e efikasitetit të energjisë.

I.3.2 Përgjegjësia e Operatorit të Sistemit të shpërndarjes tij fillon nga pika hyrëse, gjegjësisht lidhja me stabilimentet e Prodhuesit(ve) të energjisë termike, më saktësisht nga valvolat e para në dalje të kolektorit të përbashkët të energjisë termike gjer tek dhe duke përfshirë pikën furnizuese të nënstacionit termik të konsumatorit ku behët këmbimi dhe matja e energjisë termike të shpenzuar nga konsumatori.

I.4 Përdorimi i shënimeve dhe informatave (konfidencialiteti)

I.4.1 OSSH është i obliguar të mos i zbulojë të dhënat dhe informatat konfidenciale të mbledhura nga shfrytëzuesit (përdoruesit) përfshirë dhe konsumatorët, përveç kur me rregullore kërkohet publikimi i të dhënave apo përcjellja tek autoritetet shtetërore.

I.4.2 OSSH-së nuk i lejohet të abuzojë me të dhënat dhe informatat e shfrytëzuesve (përdoruesve) të sistemit. OSSH duhet të ruajë të dhënat personale përderisa nevojiten për qëllime të caktuara, për të cilat janë grumbulluar dhe proceduar më tej.

I.4.3 Shënimet ekzistuese personale të shfrytëzuesve (përdoruesve) përfshirë edhe të dhënat e konsumatorëve të energjisë termike duhet të përdoren sipas udhëzimeve që rregullojnë konfidencialitetin e shënimeve personale, në pajtim me ligjin dhe në mënyrë të ndershme. Për shkak të sigurisë së të dhënave personale, OSSH duhet të organizojë procedura organizative, teknike dhe logjistike me të cilat do të ruajë /arkivojë të dhënat personale, të pamundësuar shkatërrimin e të dhënave me ose pa qëllim, humbjen apo dëmtimin e tyre si dhe përdorimin e paautorizuar të tyre.

I.5 Rrethanat e Paparashikuara

I.5.1 Nëse shfaqen rrethana të cilat nuk janë të parashikuara në dispozitat e Kodit të Shpërndarjes, atëherë OSSH, deri në masën e mundshme të arsyeshme praktike për rrethanat, menjëherë dhe me mirëbesim do të konsultojë Shfrytëzuesit (Përdoruesit) e ndikuar nga rrethanat e paraqitura duke u përpjekur për të arritur marrëveshje për atë se çfarë duhet bërë. Nëse marrëveshja nuk mund të arrihet brenda kohës në dispozicion, OSSH-ja do të përcaktojë vetë se si duhet vepruar.

I.5.2 Kurdo që OSSH merr një vendim, do të ketë kujdes që të marrë parasysh pikëpamjet e

Shfrytëzuesve (Përdoruesve) deri në atë masë që është e arsyeshme për këto rrethana. OSSH do ta njoftojë ZRRE-në dhe Ministrinë përgjegjëse për energji për veprimet e ndërmarra.

- I.5.3 Çdo Shfrytëzues (Përdorues) duhet të veprojë në përputhje me të gjitha udhëzimet që i janë dhënë nga OSSH-ja duke zbatuar një vendim të tillë nën kushtin që udhëzimet e dhëna të jenë në përputhje me parametrat teknik të sistemit të Shfrytëzuesit (Përdoruesit), i regjistruar në Kodin e Shpërndarjes.

I.6 Situatat e Jashtëzakonshme (Emergjente)

- I.6.1 Në rast të situatave të jashtëzakonshme (emergjente) dispozitat e Kodit të Shpërndarjes mund të pezullohen, në tërësi apo pjesërisht, në përputhje me udhëzimet e dhëna dhe/apo urdhëresat e bëra nga Ministria përgjegjëse për energji në përputhje me legjislacionin në fuqi.

I.7 Hierarkia

- I.7.1 Në rast të ndonjë konflikti në mes dispozitave të Kodit të Shpërndarjes dhe çfarëdo kontrate, marrëveshje apo aranzhimi në mes OSSH-së dhe Shfrytëzuesit (Përdoruesit), dispozitat e Kodit të Shpërndarjes do të mbizotërojnë përveç nëse Kodi i Shpërndarjes në mënyrë të qartë e parasheh ndryshe.

I.8 Ndryshimet dhe Plotësimet e Kodit të Shpërndarjes

- I.8.1 Kodi i Shpërndarjes përcakton kushtet të cilat duhet të zbatohen nga të gjitha palët. Rishikimi i Kodit të Shpërndarjes do të iniciohet nga OSSH ose cilado palë tjetër. OSSH është e obliguar për të paraqitur për konsultim / diskutim publik ndryshimet dhe plotësimet e propozuara të Kodit.
- I.8.2 OSSH duhet të hartoj versionin përfundimtarë të Kodit me ndryshimet dhe plotësimet e dakorduara dhe ta dorëzoj për aprovim në ZRRE.

I.9 Komunikimet në mes OSSH dhe Shfrytëzuesve (Përdoruesve)

- I.9.1 Me përjashtim të rasteve kur është specifikuar ndryshe me Kodin e Shpërndarjes, metodat e komunikimit të punës dhe transferimi i të dhënave duhet të rregullohet me marrëveshjet përkatëse në mes të OSSH-së dhe Shfrytëzuesve (Përdoruesve).

I.10 Derrogimet

- I.10.1 Nëse ndonjë Shfrytëzues (Përdorues) vlerëson se nuk është, dhe nuk do të jetë në

gjendje për t'i zbatuar dispozitat e Kodit të Shpërndarjes, atëherë pa vonesë kjo duhet të raportohet tek OSSH; gjithashtu për rastet e mospërputhjes duhet kërkuar derogim, si dhe duhet të bëhen përpjekje të arsyeshme për të evituar atë mospërputhje në mënyrën sa më shpejtë praktike të mundshme, sipas afatit të përcaktuar në derogim.

I.10.2 Kërkesa për derogim prej ndonjë dispozite të Kodit të Shpërndarjes duhet të përmbajë:

- a) numrin e nenit (dispozitës) të Kodit të Shpërndarjes, kundrejt së cilit është identifikuar apo parashikuar mospërputhja;
- b) identifikimi i stabilimentit dhe/ose pajisjeve në lidhje me të cilat është kërkuar derogimi, nëse janë relevante, natyra dhe shtrirja në të cilën ekziston mospërputhja;
- c) identifikimi i dispozitës me të cilin Shfrytëzuesi (Përdoruesi) nuk është, apo nuk do të jetë, në gjendje të jetë në përputhshmëri;
- d) arsyeja për mospërputhje; dhe
- e) data në të cilën do të arrihet përputhshmëria (nëse përmirësimet e mospërputhjes janë të mundshme).

I.10.3 Nëse OSSH konstaton se nuk është, apo nuk do të jetë, në gjendje të veprojë në përputhje me ndonjë dispozitë të Kodit të Shpërndarjes, atëherë duhet që të kërkoj derogim nga ZRRE sipas pikës I.10.2, si dhe të bëjë përpjekje të arsyeshme për të përmirësuar një mospërputhje të tillë sipas afatit të përcaktuar në derogim .

I.10.4 Me pranimin e ndonjë kërkesë për derogim, ZRRE e bën vlerësimin përkatës të arsyeshmërisë së derogimit; në rast të vlerësimit se derogimi është i arsyeshëm ZRRE do të lejoj (aprovoj) një derogim të tillë përveç në rastet kur ky derogim do të ketë ose pritet që të ketë ndikim të pafavorshëm në sigurinë dhe stabilitetin e Sistemit të Shpërndarjes apo do të imponojë kosto të paarsyeshme në operimin e Sistemit të Shpërndarjes, apo në Shfrytëzuesit (Përdoruesit) tjerë.

I.10.5 Gjatë shqyrtimit të kërkesës për derogim, ZRRE mund të kërkoj nga parashtruesi i kërkesës sqarime, të dhëna dhe informata shtesë.

I.10.6 OSSH duhet të:

- a) mbajë regjistrin e të gjitha derogimeve të cilat janë pranuar, identifikimi i personit në emër të cilit është pranuar derogimi, dispozita relevante e Kodit të Shpërndarjes dhe periudha e derogimit; dhe
- b) me kërkesë të ndonjë Shfrytëzuesi (Përdoruesi), duhet të sigurojë një kopje të regjistrit të derogimeve.

I.11 Kontestet (Mosmarrëveshjet)

I.11.1 Në rast të ndonjë kontesti (mosmarrëveshjeje) ndërmjet OSSH dhe Shfrytëzuesve (Përdoruesve), kontesti (mosmarrëveshja) do të zgjidhet sipas Procedurës për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë të nxjerrë dhe aprovuar nga ZRRE. Në rast mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të këtij Kodi dhe akteve të tjera nën-ligjore të miratuara nga ZRRE, kjo e fundit vendos për dispozitat që do të mbizotërojnë.

I.12 Administratori i Kodit

I.12.1 OSSH do të veprojë si administrator i këtij Kodi dhe si i tillë duhet të ushtroj të gjitha funksionet e detajuara në I.12.2 në mënyrë profesionale, në afatin e përcaktuar kohor dhe në mënyrë jo-diskriminuese.

I.12.2 Funksionet e administratorit të kodit do të përfshijnë si më poshtë:

- a) Mbajtjen e kopjes kryesore të azhurnuar të Kodit të Shpërndarjes duke siguruar se janë përfshirë të gjitha rishikimet e miratuara në të;
- b) Publikimin (shpalljen) e versionit aktual të miratuar në faqen elektronike zyrtare;
- c) Publikimin (shpalljen) e ndryshimeve dhe plotësimeve të propozuara në faqen elektronike zyrtare (për konsultime);
- d) Publikimin (shpalljen) e ndryshimeve dhe plotësimeve të miratuara në faqen elektronike zyrtare;
- e) Informimin me shkrim i të gjithë Shfrytëzuesve (Përdoruesve), për ndryshimet dhe plotësimet e propozuara, të miratuara ose për versione të reja të Kodit të Shpërndarjes të publikuar në faqen elektronike zyrtare.

II. NOCIONET DHE PËRKUFIZIMET

Në këtë dokument përdoren termat dhe nocionet që kanë kuptimin si në vijim:

Operatori i Sistemit të shpërndarjes së energjisë termike	është person juridik ose fizik përgjegjës sipas licencës për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike;
Shpërndarja energjisë termike	nënkupton procesin e transportimit dhe shpërndarjes së energjisë termike përmes rrjetit të shpërndarjes nga prodhuesi(it) gjer tek konsumatorët;
Sistemi i shpërndarjes së energjisë termike	nënkupton sistemin e gypave dhe pajisjeve të kyçura të parapara për transportimin dhe shpërndarjen energjisë termike nga gypi i kyçjes (lidhës) me prodhuesin(t) e energjisë termike gjer tek nënstacionet e konsumatorëve, dhe që operohet nga Operatori i sistemit të shpërndarjes;

qasja	qasja në përdorimin e rrjetit të shpërndarjes për pranimin dhe dërgimin e sasisë së energjisë termike të kontraktuar në periudhën e dakorduar;
pajisja matëse	është matës i energjisë termike në pikën e furnizimit i cili direkt njehson dhe e tregon (për lexim) energjinë termike të furnizuar tek konsumatorët;
konsumatori i energjisë termike	është çdo subjekt fizik apo juridik cili furnizohet me energji termike, në bazë të kontratës për furnizim, dhe i cili mund të jetë konsumator fundorë ose të furnizoj konsumatorët tjerë fundorë;
pika e kyçjes (dërguese)	është lokacion në nënstacionin e energjisë termike ku Operatori i sistemit të shpërndarjes, sipas kushteve të përcaktuara , mundëson kyçjen në rrjetin e shpërndarjes nga ku konsumatori furnizohet më pastaj;
pika pranuese	është pika në rrjetin e shpërndarjes në të cilën OSSH, sipas kontratës me Shfrytëzuesin (përdoruesin), pranon për shpërndarje sasi të dakorduar të energjisë termike;
kyçja	realizimi i kyçjes fizike të gypit lidhës në rrjetin ekzistues të shpërndarjes;
shkyçja	realizimi i shkëputjes e gypit lidhës nga rrjeti ekzistues i shpërndarjes, që ekzekutohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes me kërkesë të furnizuesit ose për arsye të sigurisë apo mbrojtjes së aseteve;
kapaciteti kyçës	është kapaciteti nominal i pajisjeve të brendshme termike të përcaktuar me dokumentacionin e projektimit, në përputhje me udhëzimet e operimit dhe kërkesat teknike të OSSH për kyçjen në rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike;
gyp lidhës	është gyp i cili furnizon me energji termike ndërtesën e caktuar dhe është lidhje nga pika lidhëse në gypin kryesor deri tek nënstacioni termik;
nënstacioni termik	është pjesa lidhëse në mes të Sistemit të shpërndarjes së energjisë termike (përfshirë gypin lidhës) dhe pajisjeve termike të brendshme të konsumatorëve. Është i vendosur në mes të pikës së kyçjes dhe pajisjeve të brendshme të ngrohjes së ndërtesës dhe ndikon në drejtimin e furnizimit të energjisë termike në pajisjet e brendshme për ngrohje;
Shfrytëzuesi (përdoruesi)	është subjekti fizik apo ligjor i cili furnizohet me energji termike nga rrjeti i shpërndarjes ose dërgon energji termike në rrjetin e

rripi i sigurisë së rrjetit shpërndarës

shpërndarjes; këtu përfshihen: Furnizuesi publik, furnizuesit tjerë (nëse ekzistojnë), Prodhuesi(t) e energjisë termike të kyçur në Sistemin e Shpërndarjes, konsumatorët e kyçur në Sistemin e shpërndarjes, si dhe çdo person tjetër fizik dhe juridik që shfrytëzon shërbimet e Sistemit të shpërndarjes; është zona me gjerësi 1.0 m në çdo anë të përmasave të jashtme të elementeve të rrjetit të shpërndarjes;

pajisjet e brendshme për ngrohje

pajisje për ngrohje të hapësirave dhe të ujit sanitarë të cilat sigurojnë kushte të përshtatshme jetese dhe pune në ndërtesë , që janë të kyçura në nën-stacionin e ndërtesës - përdoren pajisje të ndryshme për ngrohje si: radiator, konvektor dhe ngrohje e dyshemesë, ngrohje me fryrje dhe ventilim, kondicionimi i ajrit të lokaleve, përgatitja e ujit të nxehtë sanitar, etj;

III. KUSHTET TEKNIKE DHE KUSHTET TJERA PËR FUNKSIONIM TË SIGURT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES

III.1 Karakteristikat e Sistemit të shpërndarjes së energjisë termike

- III.1.1 Sistemi i shpërndarjes përfaqëson sistemin e gypave dhe pajisjeve të ndërlidhura me qëllim të transportimit dhe shpërndarjes së energjisë termike nga pika pranuese tek gypi lidhës në stabilimentet e Prodhuesit(ve) të energjisë termike deri të pika e furnizimit në nënstationit termik, ku energjia termike i dërgohet konsumatorit.
- III.1.2 OSSH, përmes planifikimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së duhur të rrjetit të shpërndarjes, me një menaxhim të mirëfilltë dhe kontrollim të rrjetit të shpërndarjes, si dhe monitorimin e të gjitha intervenimeve në zonën e sigurisë së sistemit të shpërndarjes, siguron operim të sigurt dhe të besueshëm të rrjetit të shpërndarjes për të mundësuar furnizim me energji termike të konsumatorëve në përputhje me kontratën e furnizimit.
- III.1.3 Veçoritë themelore të Sistemit të shpërndarjes së energjisë termike të NQ Termokos janë:
- Gjatësia totale e gypave të rrjetit të shpërndarjes është rreth 70,000 m;
 - Në Sistemin e Shpërndarjes janë të kyçur 312 nënstacione me kapacitet total të kyçjes prej rreth 135 MW_t;
 - Kapaciteti specifik për një kilometër të linjës gypore është 1.93 MW_t/km;
 - Mënyrë indirekte e kyçjes përmes nënstacioneve termike;
 - Fluidi bartës i energjisë termike: uji i nxehtë;
 - Temperatura maksimale nominale e ujit furnizues: 140 °C;

- g) Temperatura maksimale nominale e ujit kthyes: 80 °C; (gjatë temperaturës së jashtme minimale prej -18°C;
- h) Vlera nominal e presionit në rrjet: 16 bar;

III.1.4 Temperatura e jashtme projektuese për rajonin e Prishtinës është – 18 °C.

III.2 Planifikimi dhe zhvillimi i Sistemit të shpërndarjes

III.2.1 OSSH ka të drejtën dhe përgjegjësinë që të përgatit propozimet për planifikim të zhvillimit të mëtejshëm të Sistemit të shpërndarjes në bazë të ligjeve, rregulloreve, standardeve dhe udhëzimeve në fuqi.

III.2.2 Planifikimi dhe zhvillimi i Sistemit të Shpërndarjes ka për qëllim:

- a) Të përgatis planin zhvillimor të Sistemit të shpërndarjes për të mundësuar shpërndarjen e energjisë termike në mënyrë të sigurt, në sasi dhe kualitet të kërkuar nga Shfrytëzuesit (përdoruesit) dhe sipas kërkesave të licencës;
- b) Të orientoj dhe të inkurajoj investimet në sistemin e shpërndarjes me efikasitet ekonomik dhe teknik.

III.2.3 Përgatitja e planit zhvillimor të Sistemit të Shpërndarjes duhet të bazohet në:

- a) Parashikimin e kërkesës së konsumatorëve për energji termike në baza vjetore;
- b) Parashikimin e prodhimit të energjisë termike në baza vjetore dhe 5 vjeçare;
- c) Strategjitë dhe planet zhvillimore, urbanistike dhe rregulluese të komunës.

III.2.4 Planifikimi i Sistemit të shpërndarjes i afekton edhe të gjithë shfrytëzuesit (përdoruesit) e Sistemit të shpërndarjes ku përfshihen: prodhuesi(t) e energjisë termike, furnizuesi publik dhe furnizuesit tjerë (nëse ekzistojnë); dhe të gjithë konsumatorët e kyçur në rrjetin e shpërndarjes.

III.2.5 OSSH specifikon kriteret, dhe standardet teknike dhe të projektimit për planifikimin e sistemit të shpërndarjes, si dhe procedurat të cilat OSSH do ti përmbahet gjatë planifikimi dhe zhvillimit të rrjetit. Gjithashtu edhe Shfrytëzuesit (Përdoruesit) duhet ti përmbahen këtyre standardeve, kriterëve dhe procedurave gjatë planifikimit dhe zhvillimit të rrjetit të vet sekondar dhe instalimeve përkatëse të cilat ndikojnë në Sistemin e shpërndarjes.

III.2.5 Standardet, kriteret dhe procedurat e planifikimit, si dhe kushtet dhe standardet teknike të projektimit dhe realizimit (ndërtimit) të pjesëve të rrjetit të shpërndarjes, janë të përshkruara detajisht në dokumentin: Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes.

III.3 Mirëmbajtja, riparimet dhe testimi i Sistemit të shpërndarjes

- III.3.1 OSSH është e obliguar t'i përdor me efikasitet teknik dhe ekonomik, si dhe t'i mirëmbaj rregullisht objektet, pajisjet dhe linjat gypore të Sistemit të shpërndarjes, duke përfshirë nënstationet gjer në kufirin (pikën ndarëse) ndërmjet rrjetit primar dhe atij sekondarë, gjegjësisht ndërmjet pjesës primare dhe sekondare të Sistemit të shpërndarjes.
- III.3.2 Kufiri në mes të OSSH dhe Konsumatorit-instalimeve sekondare shtëpiake, shikuar në drejtimin e qarkullimit së ujit të nxehtë, është në pjesën primare të nënstationit termik përfshirë edhe këmbyesin e nxehtësisë gjegjësisht në valvolat e para në dalje të këmbyesit të nxehtësisë në drejtim të konsumatorit –instalimeve sekondare shtëpiake.
- III.3.3 Me qëllim të përgatitjes së sistemit për sezonin e ardhshëm të ngrohjes, menjëherë pas përfundimit të sezonit të ngrohjes, OSSH fillon me riparimin dhe punët tjera në strukturën dhe pajisjet e Rrjetit të shpërndarjes; aktiviteti duhet të kryhet deri më datën 30 Shtator të vitit aktual.
- III.3.4 Në periudhën prej 1 deri më 10 Tetor OSSH është e obliguar të kryej testimin e funksionimit të rrjetit të shpërndarjes përfshirë edhe pajisjet përkatëse. OSSH është e obliguar t'i informoj, përmes mediave, të gjitha palët e interesuara për itinerarin testues së paku pesë (5) ditë para testimit dhe në formë të shkruar njësinë organizative përgjegjëse për inspektim të Komunës së Prishtinës.
- III.3.5 Sistemi sekondarë i instalimeve në ndërtesat e konsumatorëve që janë është kyçur me sistemin e ngrohjes qendrore duhet të mirëmbahet dhe riparohet rregullisht, si dhe të kryhen testimet përkatëse.
- III.3.6 Riparimet dhe punimet përgatitore për sezonin e ngrohjes, të sistemit sekondarë të instalimeve të ngrohjes në ndërtesat e konsumatorëve, duhet të përfundojnë deri më 30 Shtator të vitit aktual.
- III.3.7 Për mirëmbajtjen dhe riparimet e sistemit sekondarë përgjegjës është pronari i ndërtesës gjegjësisht autoriteti menaxhues i ndërtesës. Pronari apo organi menaxhues i ndërtesës mund të lidh marrëveshje për mirëmbajtje të instalimeve shtëpiake me OSSH, operatorë ekonomik apo ndërmarrës të tjerë të cilët janë të regjistruar për këtë lloj pune.
- III.3.8 Nëse pronari apo organi menaxhues i ndërtesës, i cili sipas pikës III.3.7 lidhë marrëveshje me ndonjë operatorë ekonomik ose ndërmarrës tjerë, atëherë është i obliguar të informojë OSSH për kompaninë kontraktuese brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes.

III.3.9 Qasja në hapësirat ku gjenden nënstacionet termike është e lejuar vetëm për zyrtarët dhe personat e autorizuar të OSSH, ose të operatorit ekonomik që mirëmban instalimet shtëpiake të ngrohjes dhe konsumatorët respektiv, sipas dispozitave të Kodit për qasje tokë dhe ndërtesa.

III.3.9 Çdo qasje në nënstacion duhet të regjistrohet në dosjen e nënstacionit. Çelësi i godinës ku gjendet nënstacioni duhet të jetë në dispozicion të OSSH dhe pronarit të ndërtesës, apo të personit të caktuar nga organi menaxhues i ndërtesës; çelësi duhet vendosur në kuti me kapak të vulosur nga OSSH. Emri i personit i cili mban çelësin e hyrjes duhet të ceket në ndonjë vend të dukshëm të godinës apo ndërtesës banuese. Qasja në nënstacion nuk lejohet pa praninë e personit të autorizuar të OSSH, përpos në raste rreziku për të cilat OSSH duhet njoftuar menjëherë.

III.4 Mbikëqyrja dhe sigurimi i Sistemit të shpërndarjes

III.4.1 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSh) të energjisë termike është përgjegjës për mbikëqyrjen e funksionimit dhe menaxhimin e Sistemit të shpërndarjes.

III.4.2 Mbikëqyrja e funksionimit dhe menaxhimi i Sistemit të shpërndarjes kryhet në mënyrë vizuale dhe me anën e pajisjeve kontrolluese, matëse, regjistruese, telemetrike dhe "software"-eve përkatës, dhe përfshinë:

- a) Mbikëqyrjen dhe kontrollimin e sasive dhe parametrave përkatës të energjisë termike e cila dërgohet nga prodhimi në rrjetin e shpërndarjes;
- b) Mbikëqyrjen dhe menaxhimin e shpërndarjes së energjisë termike;
- c) Mbikëqyrjen dhe menaxhimin e funksionimit të Sistemit të shpërndarjes, parashikimin e konsumit sipas zonave të shërbimit, dhe alokimin e sasive përkatëse të energjisë termike;
- d) simulimin dhe përcjelljen e parametrave të presionit qarkullues në rrjetin e shpërndarjes;
- e) identifikimi dhe lajmërimi i situatave kritike dhe parametrave ç'ekuilibrues të punës;
- f) mbikëqyrja e funksionimit të ndërtesave kryesore në rrjetin shpërndarës (p.sh. nënstacionet termike) gjithashtu dhe lokaleve tjera;

III.4.3 Në mënyrë që të mundësoj funksionim të sigurt dhe të qëndrueshëm të Sistemit të shpërndarjes, OSSH ka të drejtë dhe përgjegjësi të mbikëqyrë ndërtimin e rrjetit të shpërndarjes dhe nënstacioneve termike si dhe të përgatit kërkesat minimale teknike që duhet përmbushur gjatë ndërtimeve të rrjetit të shpërndarjes.

III.4.4 Mbikëqyrja e ndërtimeve të rrjetit të shpërndarjes dhe instalimeve përcjellëse përfshinë detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

- a) Vërtetimin e përputhshmërisë së realizimit të ndërtimeve sipas projekteve, si dhe aprovimi dhe mbikëqyrja e çdo ndryshimi gjatë zbatimit (realizimit) të projektit;
- b) Mbikëqyrja dhe sigurimi që çdo shtesë apo ndryshim i rrjetit të shpërndarjes, i kryer nga investitorët, të mos ndikojnë në funksionimin e rregullt të rrjetit dhe gjithashtu këto shtesa / ndryshime të regjistrohen dhe arkivohen;
- c) Mbikëqyrja e realizimit të kyçjeve të reja dhe koordinimi i afateve kohore për realizimin e kyçjes së gypave në rrjetin ekzistues;
- d) Koordinimi i afateve kohore për mbushjen e gypave të nënstacionit termik me mediumin bartës të energjisë termike dhe të fillimit të furnizimit me ngrohje;
- e) Të siguroj se projektet e realizimit të linjave gypore dhe nën-stacioneve termike përfshirë edhe revidimet e këtyre projekteve të arkivohen në arkivin e OSSH-së;
- f) Të certifikoj se linjat gypore të rrjetit të shpërndarjes dhe nënstacionet termike janë realizuar sipas projektit dhe se mundësojnë operim të sigurt dhe të qëndrueshëm me rastin e kyçjes në Sistemin e shpërndarjes;
- g) Të mbikëqyrë çfarëdo intervenimi të palëve të treta në zonën e sigurisë, duke siguruar se këto intervenime kryhen sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në aprovimin e dhënë nga OSSH.

III.4.5 Pas përfundimit të punimeve në zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes dhe ndërtimin e nënstacioneve termike – linjat gypore shtesë dhe pajisjet përcjellëse të rrjetit të shpërndarjes duhet regjistruar në hartat gjeodezike gjithnjë sipas rregulloreve në fuqi.

III.4.6 Për të siguruar mbrojtjen e rrjetit të shpërndarjes – linjat gypore, pajisjet dhe ndërtesat përcjellëse, si dhe sigurinë e popullatës në zonën e rrjetit të shpërndarjes, OSSH do të lëshoj leje/aprovim për aktivitete të planifikuara të palës së tretë brenda rripit të sigurisë së rrjetit të shpërndarjes dhe instalimeve përkatëse.

III.4.7 Në bazë të kërkesës me shkrim për lëshimin e lejes për kryerjen e punimeve brenda rripit të sigurisë dhe sipas dokumenteve të propozuara teknike, OSSH do të shqyrtoj kërkesën për lëshimin e lejes, gjithnjë duke respektuar dispozitat e rregulloreve teknike.

III.4.8 Aktivitetet në rripin e sigurisë, duhet të realizohet sipas kërkesave / kushteve teknike të përcaktuara në lejen e lëshuar nga OSSH dhe në përputhje me rregullat dhe standardet e ndërtimit në fuqi.

III.5 Shërbimi i gatishmërisë së përhershme

III.5.1 OSSH duhet të organizoj shërbimin e gatishmërisë së përhershme, e cila do të mbikëqyr funksionimin e Sistemit të shpërndarjes 24 orë në ditë.

III.6 Kryerja e aktiviteteve në Sistemin e shpërndarjes

III.6.1 Për funksionim të sigurt dhe të qëndrueshëm të Sistemit të shpërndarjes, OSSH është i obliguar të kryej aktivitetet vijuese:

- a) Mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes dhe pajisjeve përkatëse;
- b) Intervenime të rregullta dhe të jashtëzakonshme si dhe riparime, renovime dhe ristrukturime të paparashikuara të rrjetit të shpërndarjes dhe instalimeve dhe pajisjeve përcjellëse;
- c) Mbrojtjen e rrjetit nga ndikimet mekanike, elektrike dhe kimike;
- d) Kontrollimin sistematik të rrjetit të shpërndarjes;
- e) Mbikëqyrjen e trasesë dhe aktiviteteve të palës së tretë në rripin e sigurisë;
- f) Servisimin e pajisjeve dhe instalimeve;
- g) Mbikëqyrjen, mirëmbajtjen dhe riparimet e pikave të kyçjes.

III.6.2 Të gjitha punët në rrjetin shpërndarës duhet të kryhen sipas udhëzimeve operativo-teknologjike të OSSH-së. Kryerja e punëve duhet bërë nga kontraktorët e kualifikuar dhe dëshmuar profesionalisht.

III.6.3 Udhëzimet e operativo-teknologjike të dhëna nga OSSH duhet të përmbajnë masat që duhet ndërmarrë si në vijim:

- a) Masat për operim të sigurt;
- b) Masat në rastet e emergjencës dhe rrezikimit të rrjetit të shpërndarjes;
- c) Orari i kontrollit sistematik;
- d) Mënyrën e mirëmbajtjes së gypave, lidhjeve të salduara apo tjera, bazamentit të gypave, valvulave dhe elementeve tjera përcjellëse;
- e) Masat për të eliminuar shkaqet për rrjedhjet e mediumit bartës nga gypat e rrjetit të shpërndarjes;
- f) Masat për trajtimin kimik të ujit në rrjetin e shpërndarjes; dhe
- g) Masat tjera të nevojshme për të kryer aktivitetet e përshkruara në III.6.1.

III.7 Punimet e planifikuara në Sistemin e shpërndarjes së energjisë termike

III.7.1 OSSH ka të drejtë të ndërpres përkohësisht shpërndarjen e energjisë termike për shkak të riparimeve dhe mirëmbajtjes së planifikuar, e gjithashtu edhe për shkak të shqyrtimit apo kontrollimit të matësve, si dhe për shkak të zgjerimit të rrjetit.

III.7.2 Punimet e planifikuara duhet të kryhen në kohën e përshtatshme – kryesisht jashtë sezonit të ngrohjes, ashtu që konsumatorët të mos kenë ndërprerje të furnizimit. Në rastet kur disa punime / aktivitete duhet të kryhen gjatë sezonit të ngrohjes atëherë

OSSH duhet të kujdeset që konsumatorëve t'ju ndërprehet furnizimi sa më pak që është e mundur. Për kufizimet në furnizim apo ndërprerjet e çastit të furnizimit me energji termike si pasojë e kryerjes së këtyre punëve, OSSH nuk është përgjegjës për kompensim të konsumatorëve apo të shfrytëzuesve tjerë të sistemit.

III.6.6 OSSH është i obliguar të informoj me shkrim dhe me kohë të gjithë shfrytëzuesit e sistemit përfshirë edhe konsumatorët e afektuar për ndërprerjen e shpërndarjes gjegjësisht furnizimit. Në rastet kur ndërprerja përfshinë një grup më të madh konsumatorësh duhet të njoftohen përmes mediave dhe atë 48 orë para ndërprerjes së furnizimit.

III.6.7 Njoftimi nga III.6.6 duhet të përmbaj:

- a) Zonën e rrjetit të shpërndarjes në të cilën është duke u punuar;
- b) Fillimi dhe mbarimi i supozuar i punimeve;
- c) Skica e zonës ku parashihet kufizimi apo ndërprerjes së shpërndarjes së energjisë termike;
- d) Listën e lokacioneve dhe ndërtesave të cilat do të ndikohen nga kufizimi / ndërprerja e shpërndarjes gjegjësisht furnizimit të energjisë termike.

III.8 Punimet e pa-planifikuara – të jashtëzakonshme

III.8.1 Në rast të avarive ose të dëmtimeve të paparashikuara, OSSH duhet në afatin sa më të shkurtër kohor, të merr të gjitha masat e duhura dhe të kryej të gjitha riparimet e nevojshme për të rivendosur funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjetit të shpërndarjes.

III.8.2 Në rastet e përshkruara në III.8.1, OSSH duhet që të njoftoj sa më shpejt që është e mundur shfrytëzuesit e sistemit dhe konsumatorët e afektuar, duke theksuar shkaqet për ndërprerjen e operimit në rrjetin e shpërndarjes dhe kohën e parashikuar për eliminimin e avarive dhe/ose dëmtimeve gjegjësisht të rikthimit të funksionimit normal të rrjetit të shpërndarjes.

III.8.3 OSSH nuk është përgjegjës për kompensimin e dëmit për shkak të ndërprerjes apo kufizimit të shpërndarjes së energjisë termike për rastet e cekura në III.8.1.

III.8.4 Nëse vërtetohet se avaritë ose dëmet janë shkaktuar nga ndonjë palë e tretë, atëherë ajo palë bartë të gjitha shpenzimet e punëve riparuese dhe për sanimin e gjendjes, si dhe është përgjegjëse për kompensimin e dëmit eventual të shkaktuar konsumatorëve dhe shfrytëzuesve tjerë të sistemit.

III.9 Shkyçja nga rrjeti i shpërndarjes – Ndërprerja e furnizimit me energji termike

III.9.1 OSSH, në bazë të njoftimit të mëhershëm, mund ta ndërpret furnizimin gjegjësisht ta shkyç nga rrjeti i shpërndarjes një shfrytëzues, në rastet kur shfrytëzuesi:

- a) Pengon shpërndarjen / furnizimin e konsumatorëve tjerë të energjisë termike ;
- b) Pengon dhe ndalon personat të cilët janë të autorizuar nga OSSH-ja të kanë qasje në: gypin lidhës, dhe në gjitha pajisjet dhe instalimet e nënstacionit termik, si dhe instalimet e brendshme në ndërtesë, për të kryer kontrollin, mirëmbajtjen apo riparimet e nevojshme për të eliminuar avaritë ose pengesat e shkaktuara;
- c) Kyç në rrjet pajisjet e veta energjetike pa lejen e OSSH apo nëse përmes pajisjeve të tij mundëson kyçjen e konsumatorëve gjegjësisht shfrytëzuesve tjerë (përdoruesve të tjerë);
- d) Nuk merr parasysh vërejtjen e OSSH për të zvogëluar kapacitetin e energjisë termike sipas vlerës së kontraktuar në periudhën e kërkuar;
- e) Çaktivizon / Pamundëson regjistrimin e rregullt të vlerave të matura të furnizimit me energji termike, nuk posedon pajisjet matëse të kërkuara apo i anashkalon ato;
- f) Në qoftë pajisjet dhe aparaturat e një shfrytëzuesi / konsumatori shkaktojnë pengesa në funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, dhe se në afatin e caktuar nga OSSH nuk i eliminon këto pengesa sipas udhëzimeve të OSSH.

III.9.2 OSSH mund ta ndërpres shpërndarjen e energjisë termike gjegjësisht të shkyç nga rrjeti pa njoftim paraprak, nëse shfrytëzuesi(t):

- a) Nëse me operimin e pajisjeve të veta shkakton rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve;
- b) Në rastet e mungesës së energjisë termike, nuk respekton udhëzimet për masat kufizuese të konsumit të energjisë termike.

III.9.2 OSSH është e obliguar të riaktivizoj shpërndarjen e energjisë termike ose të rikyçë shfrytëzuesin, nëse vërtetohet se shfrytëzuesi ka eliminuar të gjitha shkaqet e ndërprerjes gjegjësisht shkyçjes nga rrjeti i shpërndarjes

III.9.3 Në rastet kur vërtetohet se OSSH pa arsye ka shkyçë nga rrjeti një shfrytëzues, OSSH duhet menjëherë të rikyçë ndërtesat, pajisjet ose aparaturat e tyre me shpenzimet vetanake. Ky shfrytëzues ka të drejtë kompensimi për dëmet eventuale të shkaktuara nga kjo shkyçje.

III.9.3 OSSH ka të drejtë të kompensohet për dëmet e shkaktuara nga shfrytëzuesi / konsumatori për rastet e përshkruara në III.9.1, dhe për të cilat është dërguar njoftimi paraprak.

IV FUNKSIONIMI (OPERIMI) I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES

IV.1 Shërbimet e sistemit

IV.1.1 Shërbimet e sistemit të cilat OSSH ju ofron Shfrytëzuesve (përdoruesve) janë:

- a) Udhëzimi mbi menaxhimin e Sistemit të shpërndarjes dhe ofrimi i qasjes në Sistemin e shpërndarjes;
- b) Sigurimi i informatave të kërkuara nga shfrytëzuesit (përdoruesit) për t'ju mundësuar qasje efikase në sistem.

IV.2 Administrimi, menaxhimi dhe ofrimi i qasjes në Sistemit të shpërndarjes

IV.2.1 Administrimi, menaxhimi dhe ofrimi i qasjes në Sistemin e shpërndarjes përfshin para së gjithash aktivitetet vijuese:

- a) Planifikimin e rrjetit të shpërndarjes për të akomoduar kapacitetet e nevojshme prodhuese;
- b) Sigurimi i funksionimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjetit të shpërndarjes;
- c) Përpunimi dhe llogaritja e të dhënave të shpërndarjes së energjisë termike dhe shërbimeve ndihmëse të sistemit;
- d) Zbatimi i masave në rast të mos-funksionimit të rregullt dhe dëmtimeve në rrjetin e shpërndarjes;
- e) Kryerjen e matjeve të energjisë termike përmes instalimit dhe kontrollimit të pajisjeve matëse përkatëse.

IV.2.2 OSSH duhet të ofroj kushte dhe parametra të balancuar për operimin e rregullt të Sistemit të shpërndarjes; parametrat kryesor operues janë përshkruar në vijim:

- a) Temperatura maksimale nominale e mediumit bartës të energjisë termike në pjesën primare të rrjetit të shpërndarjes është 140°C/80°C (temperatura furnizuese / temperatura kthyese);
- b) Presioni maksimal në pjesën primare të rrjetit të shpërndarjes është 16 bar;
- c) Temperaturat maksimale nominale e mediumit bartës të energjisë termike në pjesën sekondare të rrjetit të shpërndarjes është 90°C/70°C (temperatura furnizuese / temperatura kthyese);
- d) Presioni maksimal nominal i pjesës sekondare të rrjetit të shpërndarjes është 6 bar;

IV.2.3 Gjer në atë masë sa është e mundshme teknikisht OSSH është i obliguar të mbaj parametra të atillë të temperaturës dhe presionit rrjedhës në rrjetin e shpërndarjes të cilët garantojnë funksionim të sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjetit për të furnizuar konsumatorët me sasi të mjaftueshëm të energjisë termike për ngrohje.

- IV.2.4 Për të menaxhuar rrjetin e shpërndarjes dhe faturimin e energjisë termike, si dhe për të përcaktuar sasi të energjisë termike që hyjnë në rrjet dhe që u dërgohet konsumatorëve nga rrjeti, duhet që pajisjet matëse të jenë të instaluar në të gjitha pikat hyrëse të rrjetit dhe në të gjitha pikat e konsumit (nënstacionet termike të konsumatorëve).
- IV.2.5 Shfrytëzuesit (përdoruesit) duhet të sigurojnë se të gjitha pajisjet dhe instalimet të përdoren dhe të mirëmbahen në atë mënyrë që mos të krijojnë çrregullim të funksionimit të pajisjeve dhe instalimeve tjera të gjithë sistemit të ngrohjes qendrore.
- IV.2.5 Konsumatorët duhet të sigurojnë që pajisjet dhe instalimet e tyre t'i operojnë në mënyrë racionale dhe ti mirëmbajnë, ashtu që temperatura kthyesë e mediumit bartës të mos kalojë vlerat e përcaktuara në pikën IV.2.2.
- IV.2.6 Konsumatorët, ashtu si edhe të gjithë shfrytëzuesit (përdoruesit) duhet t'i ofrojnë OSSH-së qasje në pajisjet dhe instalimet që operohen nga OSSH, si dhe në nënstationet termike të kyçur në rrjetin e shpërndarjes, për t'i mundësuar OSSH të kryejë përgjegjësitë dhe detyrat si në vijim:
- a) Leximin, kontrollimin, mirëmbajtjen dhe ndërrimin e pajisjeve matëse;
 - b) Mirëmbajtja e lokacioneve, pajisjeve dhe instalimeve e të cilat operohen nga OSSH ;
 - c) Monitorimin dhe evidentimin e funksionimit dhe gjendjes teknike të nënstationeve termike.

IV.3 Rezervimi i kapaciteteve të rrjetit të shpërndarjes

- IV.3.1 Të dhënat për kapacitetet e rrjetit të shpërndarjes janë publike.
- IV.3.2 OSSH duhet të përgatit dhe t'i bëjë publike shënimet për kapacitetin e rrjetit të shpërndarjes bazuar në parametrat e temperaturës dhe shtypjes së rrjedhës të mediumit bartës në rrjetin e shpërndarjes; në mënyrë specifike shënimet për: kapacitetin e instaluar, të dhënat përkatëse për pranimin energjisë termike nga prodhuesi(t) dhe furnizimin e konsumatorëve me energji termike, si dhe marrëveshjen për kyçjen në Sistemin e shpërndarjes.
- IV.3.3 OSSH duhet t'i ofroj shfrytëzuesve (përdoruesve) të dhënat për kapacitetin e rrjetit më së voni 30 ditë pas pranimin të kërkesës për qasje në rrjetin e shpërndarjes.

V. KUSHTET TEKNIKE DHE KUSHTET E TJERA PËR KYÇJE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES

V.1 Të përgjithshme

- V.1.1 Për operim të qëndrueshëm dhe të sigurt të Sistemit të shpërndarjes, është e domosdoshme të kërkohet përbushja e kriterëve minimale të caktuara teknike dhe kushteve tjera të projektimit dhe funksionimit të stabilimenteve dhe pajisjeve të Shfrytëzuesve (Përdoruesve) që janë të kyçur ose kërkojnë të kyçen në Sistemin e Shpërndarjes.
- V.1.2 Kushtet e Kyçjes në Sistemin e Shpërndarjes përmbajnë parime dhe standarde të caktuara që kanë të bëjnë me procedurat për **kyçjen**, metodën e **kyçjes** dhe standardet teknike dhe të performancës.
- V.1.3 Kushtet e Kyçjes specifikojnë marrëveshjet teknike të kërkuara në kufijtë e pronësisë në mes të Sistemit të Shpërndarjes dhe Instalimeve dhe pajisjeve të Shfrytëzuesve (Përdoruesve) të Sistemit të Shpërndarjes. Kushtet e Kyçjes përmbledhin llojet e të dhënave dhe treguesit që do të kërkohen për tu bërë të disponueshëm për OSSH-në nga çdo Shfrytëzues (Përdorues) i Sistemit të Shpërndarjes.
- V.1.4 Kushtet e Kyçjes gjithashtu aplikohen nga të gjithë Shfrytëzuesit (Përdoruesit) e Sistemit të Shpërndarjes të kyçur që kërkojnë modifikimin e kyçjes ekzistuese, si dhe nga Shfrytëzuesit (Përdoruesit) që planifikojnë të kyçen në Sistemin e Shpërndarjes.
- V.1.5 Kushtet e Kyçjes në Sistemin e Shpërndarjes specifikojnë informatat që duhen të sigurohet nga Shfrytëzuesit (Përdoruesit) për të siguruar që dispozitat adekuate mund të bëhen nga OSSH për kyçjet e reja apo rritjen e kapacitetit ekzistuese.
- V.1.6 Shfrytëzuesit (Përdoruesit) e ardhshëm duhet të dorëzojnë në kohë tek **OSSH** të gjitha detajet që janë paraqitur në këtë kapitull.
- V.1.7 Në lidhje me Kushtet e Kyçjes, ekzistojnë Marrëveshjet për Kyçje, të cilat janë marrëveshje bilaterale në mes OSSH-së dhe secilit Shfrytëzues (Përdorues), dhe e cila përmban detaje specifike për secilën kyçje të Shfrytëzuesve (Përdoruesve) dhe për përdorimin e Sistemit të Shpërndarjes. Marrëveshja për Kyçje kërkon që Shfrytëzuesi (Përdoruesi) dhe OSSH të veprojnë në përputhje me kushtet e përshkruara në këtë Kod.

V.2. Objektivi

- V.2.1 Kushtet e Kyçjes definojnë standardet minimale për mënyrën e kyçjes në Sistemin e

Shpërndarjes dhe standardet teknike, të projektimit dhe të operimit me të cilat Shfrytëzuesi (Përdoruesi) i cili kyçet në Sistemin e Shpërndarjes duhet të jetë në përputhshmëri.

V.2.2 Kushtet e Kyçjes specifikojnë aranzhimet teknike të kërkuara në Kufirin e Pronësisë në mes të Sistemit të Shpërndarjes dhe instalimeve të Shfrytëzuesit (Përdoruesit).

V.2.3 Kushtet e Kyçjes specifikojnë llojin e kyçjes dhe informacionet dhe të dhënat tjera teknike mbi instalimet e ngrohjes qendrore që do të kërkohen nga secili Shfrytëzues (Përdorues) për t'i vënë në dispozicion të OSSH-së.

V.3 Qëllimi

V.3.1 Kushtet teknike dhe tjera për kyçje kanë qëllim për të përmbushur parimet si në vijim:

- a) Gjithë Shfrytëzuesit (Përdoruesit) ekzistues të Sistemit të Shpërndarjes dhe ata që planifikojnë të kenë qasje (të kyçen) në rrjetin e shpërndarjes të trajtohen në mënyrë të barabartë.
- b) Çdo kyçje e re nuk duhet të shkaktoj ndonjë efekt negativ tek Shfrytëzuesit (Përdoruesit) ekzistues, dhe/ose një kyçje e re nuk duhet të ndikohet nga efektet negative të Shfrytëzuesve (Përdoruesve) ekzistues.
- c) Të ndihmoj Shfrytëzuesit (Përdoruesit) e Sistemit të shpërndarjes që të përmbushin detyrimet e tyre dhe të sigurojnë operim dhe mirëmbajtje me cilësi të lartë të instalimeve të tyre.
- d) Të specifikoj qartë dhe në një format standard, detyrimet dhe përgjegjësitë për të gjithë Shfrytëzuesit (Përdoruesit) e Sistemit të Shpërndarjes, për çdo vend ku bëhet/modifikohet një kyçje.

V.4 Kërkesat teknike për kyçje në sistem

V.4.1 Objektet energjetike, pajisjet, aparaturat, gypat lidhës dhe nënstacionet termike që do të kyçen në rrjetin e shpërndarjes, duhet të jenë në pajtim me standardet teknike dhe të projektimit, për të siguruar operim të qëndrueshëm, të sigurt dhe kompatibil me sistemin e shpërndarjes. OSSH duhet t'ia vë në dispozicion Shfrytëzuesit potencial, kërkesat minimale teknike dhe të projektimit që duhet plotësuar, për të marrë aprovimin për kyçje në sistem.

V.4.2 Objektet energjetike, pajisjet, aparaturat, gypat lidhës dhe nënstacionet termike që do të kyçen në rrjetin e shpërndarjes duhet të ndërtohen / konstruktohen sipas standardeve teknike të njëjta apo komparative, të zbatuara për rrjetin e shpërndarjes.

V.4.3 Standardet teknike të projektimit dhe të realizimit të ndërtimit / konstruktimit janë të specifikuar në kapitujt 6, 7 dhe 8 të dokumentit: Standardet e Planifikimit dhe të Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes.

V.4.4 Ekzekutimi fizik i kycjes duhet të kryhet nga OSSH ose nga ndonjë kontraktor tjetër i kualifikuar nën mbikëqyrjen e OSSH.

V. 5 Informatat dhe të dhënat e kërkuara për Kycje

V.5.1 Për kycje në Sistemin e Shpërndarjes kërkohen informatat dhe të dhënat e caktuara në mënyrë që pas analizës teknike dhe ekonomike të vlerësohet se kycja e propozuar është e pranueshme apo jo.

V.5.2 Për aplikimin për kycje në Sistemin e Shpërndarjes kërkohen informacionet dhe të dhënat e mëposhtme:

- a) Emri i objektit energjetik / objektit të konsumit të energjisë termike;
- b) Vend-ndodhja e objektit, adresën, bashkëngjitur harta (skica) të vendndodhjes së objektit në zonën respektive të Sistemit të shpërndarjes, ku paraqitet pika e kycjes;
- c) Dëshminë e dokumentuar të pronësisë / autorizim për shfrytëzim të pronës, si dhe lejen ndërtimore;
- d) Specifikën e aktivitetit (për objekt energjetik);
- e) Shfrytëzimi i objektit (banim privat, banim kolektiv, afarizëm, etj.), si dhe sipërfaqja e objektit;
- f) Kapaciteti i Instaluar / Kapaciteti i kërkuar në kW_t;
- g) Kërkesën vjetore të vlerësuar të energjisë termike në kWh/vit;
- h) Projektin e sistemit sekondarë / instalimeve të brendshme të ngrohjes të Shfrytëzuesit (Përdoruesit) të hartuar nga inxhinier i Licencuar;
- i) Projekti i nënstacionit – pjesa ndërtimore, pajisjeve dhe instalimeve termo-energjetike, dhe instalimeve elektrike, e gjithashtu edhe skica me vendndodhjen e lokacionit të paraparë të nënstacionit termik;
- j) Projekti duhet specifikuar qartë llojin dhe parametrat kryesor teknik të sistemit sekondarë / instalimeve të brendshme të konsumatorit;
- k) Datën kur kërkohet kycja.

V.5.3 Informatat dhe të dhënat e kërkuara në fazën para realizimit të kycjes:

- a) Dëshmi mbi kualifikimin e kontraktorit që kryen punimet e nënstacionit termik dhe gypit lidhës;
- b) Deklaratën se instalimet brendshme të konsumatorit, pajisjet dhe aparatet e nënstacionit termik janë instaluar në përputhje me projektet përkatëse, sipas

standardeve dhe kërkesave teknike të OSSH.

V.5.4 Nëse vlerësimi paraprak i këtyre të dhënave tregon se kërkohet më shumë informacion i detajuar, atëherë ai do të sigurohet nga aplikuesi sipas kërkesës së OSSH-së.

V.6 Kërkesat specifike teknike dhe operative për kyçjen e njësive prodhuese të energjisë termike

V.6.1 OSSH dhe Prodhuesi i energjisë termike i cili planifikon të kyçet në Sistemin e shpërndarjes, duhet të rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre përmes përcaktimit të kushteve teknike për kyçje që duhet të plotësoj Prodhuesi i energjisë termike për të injektuar energjinë e prodhuar termike në mënyrë të sigurt në Sistemin e shpërndarjes.

V.6.2 Përcaktimi i kërkesave teknike vlen edhe për Prodhuesit ekzistues të energjisë termike që planifikojnë të kyçin njësi të reja prodhuese, ose që ndryshojnë karakteristikat teknike të njësive ekzistuese prodhuese gjer në atë masë që duhet kërkuar aprovimin për kyçje të re.

V.6.3 Gjatë përcaktimit të kushteve teknike OSSH dhe Prodhuesi i energjisë termike duhet t'ju përmbahen dispozitave të këtij kodi dhe Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me energji (kapitulli III, neni 9.3).

V.6.4 Prodhuesi i energjisë termike duhet t'ju përmbahet të gjithat udhëzimeve operative dhe teknologjike të OSSH-së.

V.6.5 Në veçanti Prodhuesi i energjisë teknike duhet të mirëmbajë parametrat kryesor teknik si në vijim:

- a) Temperatura maksimale furnizuese e mediumit bartës të energjisë termike: 140 °C;
- b) Temperatura maksimale kthyesë e mediumit bartës të energjisë termike: 80 °C;
- c) Presioni punues maksimal 16 bar;
- d) Ndryshimi maksimal i presionit në pikën e kyçjes (lidhëse) 0.75 bar;

V.6.6 Sa i përket balancimit të ngarkesës termike, niveli i mosbalancimit të ngarkesës termike në mes të një njësie prodhuese të energjisë termike dhe rrjetit të shpërndarjes nuk duhet të kaloj 5% (pesë përqind) të ngarkesës termike mesatare.

V.6.7 Prodhuesi i energjisë termike duhet të përdor dhe injektoj në Rrjetin e shpërndarjes vetëm mediumin bartës të energjisë termike të trajtuar kimikisht sipas parametrave (vetive kimike dhe fizike) të dhënë në vijim:

Vlerat minimale të lejuara të mediumit bartës të energjisë termike – ujit të nxehtë:

- | | |
|---|--------------|
| a) Përçueshmëria në 25 °C: | < 30 µS/cm; |
| b) PH në 25 °C: | 8 – 10; |
| c) Përmbajtja e Oksigjenit (O ₂): | < 0.02 mg/l; |
| d) Përmbajtja e Klorit (Cl): | < 1.0 mg/l; |
| e) Përmbajtja e hekurit (Fe): | < 0.05 mg/l |

V.7 Vendosja e Sistemit të Informimit të ndërsjellët – në mes të Prodhuesit dhe OSSH-së

V.7.1 Prodhuesi i energjisë termike duhet të krijoj një sistem për shkëmbimin e informatave me OSSH, i cili do të mundësoj shkëmbimin e së paku këtyre informatave:

- a) Informatat e Prodhuesit të energjisë termike për OSSH-në:
 - a.1) Gjendja e gatishmërisë operationale e njësisë(ve) prodhuese;
 - a.2) Vlerat e presionit të mediumit bartës në hyrje të rrjetës së shpërndarjes;
 - a.3) Vlerat e matura të rrjedhjes së mediumit bartës;
 - a.4) Vlerat e matura të temperaturës;
 - a.5) Të dhënat për kapacitetit termik në dispozicion dhe sasive të energjisë termike;
 - a.6) Të dhënat për cilësinë dhe sasinë shtesë të mediumit bartës;
 - a.7) Të dhënat tjera relevante dhe paraprakisht të dakorduara me OSSH-në.

- b) Informatat e OSSH për Prodhuesin e energjisë termike – vlerat e kërkuara të:
 - b.1) Presionit punues;
 - b.2) Rrjedhjes sasiore të mediumit bartës;
 - b.3) Temperaturës furnizuese të mediumit bartës;
 - b.4) Kapacitetit termik.

V.7.2 Prodhuesi i energjisë termike duhet të krijoj bazën e të dhënave operative e cila duhet të përmbaj këto të dhëna periodike – ditore dhe mujore:

- a) Të dhënat e integruara për rrjedhjen e fluidit bartës në pikat matëse;
- b) Të dhënat e integruara për kapacitetin (ngarkesën) termik të njërive të veçanta të prodhimit të energjisë termike;
- c) Sasia e prodhuar e energjisë termike – nga njësitë që prodhojnë vetëm energji termike;
- d) Sasia e prodhuar e energjisë termike – nga njësitë e ko-gjenerimit (bashkëprodhimit të energjisë elektrike dhe termike);
- e) Sasia e prodhuar e energjisë termike nga njësitë prodhuese të dedikuara për mbulimin e konsumit gjatë kohës së “pikut” (kërkesës maksimale);
- f) Sasia e energjisë termike për përdorim (konsum) vetanak;

- g) Të dhënat për konsumin e lëndës djegëse nga njësitë prodhuese të energjisë termike;
- h) Ngjarjet në Sistemin e shpërndarjes.

V.7.3 Për të lehtësuar komunikimin dhe shkëmbimin e ndërsjellë të informatave dhe të dhënave të përcaktuara në V.7.1 dhe V.7.2, Prodhuesit e energjisë termike duhet të instalojnë pajisje komunikimi adekuate dhe kompatible me pajisjet e komunikimit të OSSH.

V.8 Ndërprerjet e planifikuara të njësive prodhuese të energjisë termike

V.8.1 Prodhuesit e energjisë termike, në bashkëpunim dhe me pëlqimin e OSSH dhe Furnizuesit publik hartojnë orarin vjetor të ndërprerjes së planifikuar të operimit të njësive prodhuese me qëllim të kryerjes së riparimeve dhe mirëmbajtjes së rregullt. Gjatë hartimit të orarit të ndërprerjes së planifikuar të operimit të njësive prodhuese duhet marrë parasysh që konsumatorëve t'ju sigurohet furnizim i qëndrueshëm dhe cilësor i energjisë termike.

V.8.2 Prodhuesi i energjisë termike duhet që së paku 10 ditë përpara ta njoftoj OSSH-në për çdo ndryshim në orarin e ndërprerjeve të planifikuara – ndryshimet në datën e fillimit apo përfundimit të ndërprerjes, zgjatja ose shkurtimi i periudhës së ndërprerjes. Njoftimi duhet të përmbaj edhe arsyetimin për këto ndryshime. Nëse në raste të veçanta këto ndryshime nuk kanë mund të parashikohen para afatit prej 10 dite atëherë, ky njoftim mund të bëhet edhe për periudhë më të shkurtër se 10 ditë.

V.8.3 OSSH-ja verifikon nëse ky ndryshim i orarit të ndërprerjes së operimit të njësive prodhuese do të ndikoj në ç'rregullimin e operimit e sigurt të rrjetit të shpërndarjes dhe në furnizim. Pas këtij verifikimi OSSH-ja aprovon ndryshimet në orarin e ndërprerjeve të planifikuara, 72 orë para datës së ri-planifikuar të ndërprerjes së operimit.

V.8.4 Për ndërprerjen e operimit ose reduktimin e kapacitetit prodhues të njësive prodhuese, e cila nuk është planifikuar në orarin vjetor, por që duhet ndërmarrë për të parandaluar ndonjë pengesë në funksionim ose ndonjë avari, duhet ndërmarrë këto veprime:

- a) Prodhuesi i energjisë termike duhet të njoftoj OSSH-në për domosdoshmërinë e ndërprerjes ose reduktimit të kapacitetit të njësive, së paku 72 orë përpara; në rastet kur nuk ka qenë e mundur të parashikohet kjo ngjarje brenda afatit 72 orësh atëherë periudha e njoftimit mund të jetë edhe më e shkurtër.
- b) OSSH duhet ta aprovoj ose refuzoj duke dhënë arsyetimin e bazuar ndërprerjen ose reduktimin e kapacitetit, së paku 48 orë përpara datës së propozuar të ndërprerjes gjegjësisht reduktimit të kapacitetit.
- c) Pas rikthimit në gjendje të rregullt të asaj njësie prodhuese, Prodhuesi i energjisë

termike menjëherë informon OSSH për gatishmërinë (disponueshmërisë) e asaj njësie prodhuese.

V.9 Procedurat për kyçje në Sistemin e Shpërndarjes

V.9.1 Procedurat për kyçje në Sistemin e shpërndarjes që trajtojnë mënyrën a aplikimit për kyçje, vlerësimin të realizueshmërisë, përmbajtjes së ofertës dhe marrëveshjes për kyçje, janë të përshkruara në kapitulli III dhe shtojcat përkatëse të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, të nxjerr nga ZRRE.

V.9.2 Lidhur me llogaritjen e specifikimin e pagesave për të mbuluar kostot e kyçjes, detalisht trajtohen në dokumentin e veçantë Metodologjia për llogaritjen e pagesave (tarifave) të kyçjes në Sistemin e shpërndarjes.

VI CILËSIA E ENERGJISË TERMIKE

VI.1 Temperaturat e mediumit bartës të energjisë termike

VI.1.1 Temperaturat e mediumit bartës në pikat e kyçjes – nga Prodhuesit e energjisë termike në pjesën primare të rrjetit të shpërndarjes, dhe nga pjesa primare në pjesën sekondare të rrjetit (instalimeve të brendshme) të konsumatorit – varen nga temperaturat e ambientit të jashtëm.

VI.1.2 Për të siguruar një cilësi optimale të energjisë termike, temperaturat në pikat e kyçjes janë përcaktuar në Diagramin Rrëshqitës i Temperaturave¹ – shtojca 1 e këtij dokumenti.

VII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

VII.1 Ky dokument hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.

¹ Diagrami Rrëshqitës i Temperaturave është hartuar sipas temperaturës së jashtme projektuese të përcaktuar me standardet e viteve 80-të, që për zonën e III klimatike ku ishte përfshirë edhe Prishtina ishte përcaktuar në -18°C . Çfarëdo ndryshimi në përcaktimin e temperaturës së jashtme projektuese në të ardhmen do të reflektohet në revidimin e këtij Diagrami Rrëshqitës të Temperaturave.

KODI I SHPËRNDARJES - Shtojca 1:

Diagrami rrëshqitës i temperaturave [°C]

t_j	t_{pf}	t_{pk}	t_{sf}	t_{sk}
-18	140	80	90	70
-17	137	79	88	68
-16	134.5	77.5	87	67
-15	131.5	76	84	66
-14	129	74.5	83	64
-13	126	73	81	63
-12	123.5	71.5	79	62
-11	120.5	70	78	61
-10	117	69	76	60
-9	113	67.5	74	58
-8	110.5	66	73	57
-7	108	64.5	71	56
-6	105	63	69	55
-5	102.5	61.5	67	54
-4	100	60	66	52
-3	97	58	64	51
-2	94	57.5	62	50
-1	91	56	61	49
0	88	54.5	59	48
1	85	53	57	46
2	82	51.5	56	45
3	79	50	54	44
4	76	48.5	52	43
5	73.5	47	51	42
6	70.5	46	49	40
7	68	44	47	39
8	65	43	45	38
9	62.5	41.5	44	37
10	59.5	40	42	36
11	57	38.5	40	34
12	54	37	39	33

Përshkrimi i shkurtesave:

- t_j - temperatura e jashtme
- t_{pf} - temperatura furnizuese në pjesën primare
- t_{pk} - temperature kthyesë në pjesën primare
- t_{sf} - temperatura furnizuese në pjesën sekondare
- t_{sk} - temperatura kthyesë në pjesën sekondare